

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A- 073/13

**Prishtinë,
24 prill 2014**

Në çështjen juridike të:

I.B

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër.

Nuk ka

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Esma Erterzi, Kryetare e Kolegjit, Willem Brouwer dhe Sylejman Nuredini, anëtare, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) KPPC/D/R/167/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA 11794), të datës 6 shtator 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 24 prill 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e I.B kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/R/167/2012, të datës 5 shtator 2012.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/R/167/2012, i datës 5 shtator 2012 për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA11794.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 3 dhjetor 2007, I.B ka paraqitur një kërkesë për ri-posedim të një banese që ndodhet në adresën “Bekim Berisha 7/2 28 Prizren”, në katin 4, me sipërfaqe prej 57 m² në Prizren (tani e tutje referuar si: banesë). Së bashku me kërkesën, ai ka paraqitur, mes tjerash, kopjen e vendimit të Organeve Koordinuese të Brigadës së Zjarrfikësve të Prizrenit, nr. 30/228, të datës 6 dhjetor 1999, deklaratën e datës 30 qershor 2003, duke sqaruar hollësitë e ndarjes së banesës në fjalë, largimin e tij nga puna në vitin 1992, si dhe se si ai ka fituar banesën me 2 janar 2000, këtë, së bashku me shumë dokumente tjera.
2. Njoftimi i kërkesës ishte bërë me 17 korrik 2008. Personi, z. A.E, që kishte uzurpuar banesën ishte njoftuar po ashtu personalisht në Zyrën e AKP-së më 4 shkurt 2008, ku ka kërkuar të drejtën pronësore mbi banesën. Sidoqoftë, ai nuk ka paraqitur ndonjë njoftim për pjesëmarrje në procedurë e as nuk pa paraqitur ndonjë dokument.
3. KKPJ-ja ka gjetur se paraqitësi i kërkesës më parë kishte paraqitur kërkesë për të njëjtën banesë në Drejtoratin për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB) e cila ishte regjistruar me numrin DS201239. Njëkohësisht, ai ishte palë përgjegjëse në kërkesën tjetër, të paraqitur nga G.M për të njëjtën banesë në lëndën e regjistruar me numrin DS305343.
4. Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB), me vendimin e vet HPCC/D/117/2004/A&C, të datës 6 prill 2004, e ka refuzuar kërkesën e paraqitësit të kërkesës I.B (DS201239) me arsyetimin se ai nuk ka qenë në gjendje të dëshmojë se kishte pasur të drejtën pronësore që do të mund të kthehej, ndërsa e ka pranuar kërkesën e paraqitur nga G.M (DS305343).
5. Kërkesa e I.B për rishqyrtimin e vendimit të fjalë të KKPB-së po ashtu ishte refuzuar me vendimin e KKPB-së, të datës 24 shkurt 2006, me numrin HPCC/REC/43/2005. Rrjedhimisht, paraqitësi i kërkesës ishte dëbuar nga banesa nga DÇPB-ja në vitin 2005 në bazë të vendimit të KKPB-së.

6. Sa i përket kërkesës së dytë të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në AKP për të njëjtën banesë në vitin 2007, KKPK-ja vendosi më 5 shtator 2012 që të hedhë poshtë kërkesën pasi që ajo ishte jashtë juridiksionit të KKPK-së.
7. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 15 shkurt 2013. Ai ka paraqitur ankesë më 11 mars 2013.

Pretendimet e palëve të interesuara

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

8. Paraqitësi i ankesës pretendon se banesa i ishte ndarë njësisë profesionale në bazë të vendimit të lëshuar nga Komisioni për Banesa të Përbashkëta më 20 qershor 1985. Sa i përket historisë së ndarjes dhe posedimit të banesë, ai thekson se:
 - përfaqësuesi i shërbimit ishte ftuar pas vendimit për t'i marrë çelësat e banesës;
 - ishte përpiluar procesverbali i pranim-dorëzimit të çelësve i cili ishte pranuar nga zëvendëskomandanti M.T;
 - çelësat janë mbajtur në zyre deri në nxjerrjen e vendimit të plotfuqishëm të BVI-së për banim më 17 qershor 1986;
 - pas nxjerrje së vendimit të plotfuqishëm, është hapur konkursi për ndarjen e banesave në fjalë për të cilat kanë konkurruar punëtorët;
 - M.G ishte zgjedhur si anëtar i Komisionit për ndarjen e banesave;
 - M.G, para takimit të fundit për të vendosur për ndarjen e banesave, kishte shkuar dhe kishte hyrë në banesë në mënyrë të paligjshme;
 - komandanti i shërbimit Z.A kishte paraqitur një kërkesë në Komunë për dëbimin e uzurpuesit nga banesa;
 - vendimi ishte marrë më 2 gusht 198. (e palexueshme), kështu që personi duhej ta lironte banesën më 7 shtator 1987; megjithatë, ka pasur intervenime dhe ky person nuk ka mundur të largohej nga banesa;
 - më 11 nëntor 1988, është nxjerrë një dokument tjetër më kërkesë të ish-drejtorit të Hotel PUTBIK, V.L, më datën 24 qershor 1987;
 - për shkak të intervenimit nga Beogradi, personi nuk duhej të dëbohej nga banesa;
 - pastaj më 23 janar 1992, ai ishte larguar nga puna së bashku me kolegët e tij shqiptar dhe ishte detyruar që të largohej nga vendin që është një diskriminim i madh;
 - pas kthimit të tij nga Shqipëria, ai ka kërkuar nga shfrytëzuesi i banesës që ta lirojë atë por nuk ia ka arritur ta bëjë këtë;
 - më 2 nëntor 1999, është bërë një njoftim tjetër për ndarjen e kësaj banese në të cilin ai ka konkurruar dhe rrjedhimisht banesa i ishte ndarë atij;
 - ai ka kërkuar nga organet e zbatimit të ligjit që ta largojnë personin nga banesa gjë që kishte ndodhur menjëherë;

- ai ka filluar shfrytëzimin e banesës më 2 janar 2000;

9. Në ankesën e tij, ai pretendon se KKPK-ja ka marrë vendim të gabuar duke mos ofruar bazën ligjore se kujt i përket banesa dhe pse ajo nuk i përket atij dhe se cilat prova janë të pranueshme e cilat jo.

Poseduesi aktual

10. Gjatë njoftimit të pronës, shfrytëzuesi aktual i banesës A.E ka pretenduar se e kishte blerë pronën më 11 janar 2008 nga pala e tretë, G.M, të cilit i ishte ndarë banesa e kërkuar në vitin 1988. Megjithatë, nuk është paraqitur ndonjë njoftim për pjesëmarrje në procedurë.

Arsyetim ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

11. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç parashihet me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 - në tekstin e mëtejme Ligji nr. 03/L-079). Gjykata Supreme ka juridiksion mbi ankesën kundër vendimit të KKPK-së. Ankesa është e pranueshme.

Meritat e ankesës

12. Çështja që duhet të konsiderohet në këtë rast është nëse KKPK-ja kishte juridiksion për të shqyrtuar kërkesën e paraqitësit të kërkesës të paraqitur në AKP në vitin 2007.
13. Sipas nenit 3.1 të Ligjit 03/L-079, KKPK ka kompetencë për t'i zgjidhur kërkesat që janë të lidhura me konfliktin duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Prandaj, paraqitësi i kërkesës duhet të paraqes jo vetëm një titullar pronësie mbi një pronë të paluajtshme private por gjithashtu të dëshmojë se ai apo ajo aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejta të tilla pronësore për shkak të rrethanave që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur. Të dy këto kushte duhet të plotësohen. KKPK-ja kishte vendosur rreth kërkesës, ndonëse nuk kishte pasur juridiksion për të vendosur në merita për të pasi që paraqitësi i kërkesës nuk e kishte në posedim banesën në fjalë deri në vitin 2000, prandaj ai nuk e ka humbur atë për shkak të rrethanave të konfliktit të armatosur .
14. Në këtë drejtim, pikësepari, Gjykata Supreme potencon se paraqitësi i kërkesës asnjëherë nuk e ka pasur në posedim banesën para konfliktit të armatosur, pavarësisht arsyeve dhe sa korrekte dhe të drejta janë ato. Ai thjesht e pranon faktin se kishte filluar ta shfrytëzonte banesën vetën

në vitin 2000 pas shumë hapave siç përmbliidhen në pretendimet e palëve më lartë (shih parag. 8).

15. Për më tepër, argumentet e paraqitësit të kërkesës lidhur me të drejtën e tij pronësore mbi banesën kanë të bëjnë me kushtet dhe kornizën ligjore para konfliktit të cilat tashmë janë paraqitur në KKPb. Si kërkesa e I.B ashtu edhe ajo e G.M lidhur me të drejtat pronësore mbi këtë banesë janë shqyrtuar në vendimin e KKPb-së. Ai vendimi ishte marrë sipas meritave të kërkesës së I.B dhe të asaj të G.M mbi bazën e fakteve dhe argumenteve të supozuara të paraqitura si dhe provave të nxjerra nga palët gjatë procedurës.
16. Paraqitësi i kërkesës ka kërkuar rishqyrtimin e këtij vendimi. Sidoqoftë, kjo kërkesë e tij si e tillë është refuzuar edhe nga KKPb-ja më 24 shkurt 2005. Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nënkupton se ishin shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion kundër atij vendimi. Vendimi i KKPb-së është bërë i plotfuqishëm dhe detyrues për të dy palët. Argumentet e paraqitësit të njëjtë të kërkesës për të njëjtën çështje lëndore duke kundërshtuar të drejtën pronësore të të njëjtit person, G.M, nuk mund të shqyrtohen edhe një herë nga ndonjë gjykatë sepse kjo çështje është bërë *res judicata* ndërmjet I.B dhe G.M dhe ndonjë pasardhësi të G.M duke u mbështetur në të drejtën pronësore të këtij të fundit.
17. Juridiksioni i KKPb-së ishte paksa më i ndryshëm nga ai i KKPk-së. Çfarëdo argumentesh mbi të cilat bazohet paraqitësi i kërkesës për të mbështetur të drejtën e tij të supozuar mbi banesën mbi bazën e çështjeve që kanë ndodhur para konfliktit të armatosur tanimë janë shqyrtuar nga KKPb-ja, sikurse edhe ato të G.M. Kur ai vendim u bë i plotfuqishëm, ai ishte ekzekutuar. Paraqitësi i kërkesës ishte dëbuar nga banesa në vitin 2005 nga DÇPB-ja. Humbja e tij e posedimit të banesës nuk rrjedh situata që ndërlidhet me konfliktin e armatosur por ajo shfaqet si rezultat i urdhrat për dëbim në bazë të vendimi të plotfuqishëm të KKPb-së që ia ka njohur të drejtën mbi banesën e një personi tjetër, G.M.
18. Pretendimet e paraqitësit të kërkesës së KKPk-ja në vendimin e vet nuk ka bërë ndonjë deklaram rreth emrit të bartësit të së drejtës pronësore apo nuk ka vendosur se kujt i takon ajo pasqyron realitetin; megjithatë, ky është rezultati ligjor që duhet të arrihet. Gjykata mund të vendos vetëm për meritat e kërkesës, që do të thotë nëse kërkesa miratohet ose jo, nëse ka juridiksion për të gjykuar një kërkesë të këtillë. KKPk-ja, sipas këtyre rrethanave, më te drejtë ka potencuar se nuk ka juridiksion që të vendos për çfarëdo kërkesë në lidhje me pronën për humbje të posedimit i cili nuk ka ndodhur për shkak të konfliktit të armatosur. Pasi që kërkesa e re e paraqitur në AKP nga paraqitësi i kërkesës në vitin 2007 pas dëbimit nga banesa në vitin 2005 nuk rrjedh nga rrethanat e konfliktit të armatosur, konkludimi i KKPk-së se ai nuk ka juridiksion për ta shqyrtuar këtë kërkesë është i drejtë. Vendimi i KKPk-së si i tillë është që nuk parandalon ndonjë person nga kërkimi i këtyre të drejtave pranë gjykatës kompetente, nëse ka.

19. Prandaj, ankesa e paraqitësit të kërkesës hidhet poshtë si e pabazuar. Rrjedhimisht, vendimi i KKKPK-së konfirmohet në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
20. Ky aktgjykim nuk përjashton dhe kufizon të drejtën e palës për t'i kërkuar të drejtën e tij, nëse ekziston, në gjykatat kompetente kundër ndonjë personi që aktualisht e ka uzurpuar banesën, përveç G.M, për të cilin çështja është bërë *res judicata*.

Këshillë ligjore

21. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Esma Erterzi, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it